



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.110

2004

dhjetor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr.166, datë 16.12.2004	Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.....	7205
Vendim i KM nr.908, datë 29.12.2004	Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Instituteve Private të Pensioneve Suplementare dhe për procedurat e licencimit të mbikëqyrjes.....	7205
Vendim i KM nr.909, datë 29.12.2004	Për mënyrën dhe kriteret e rimbursimit të barnave për ushtarakët e Forcave të Armatosura.....	7225
Vendim i KM nr.912, datë 29.12.2004	Për një shtesë në buxhetin e vitit 2004, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.....	7226
Vendim i ERE nr.56, datë 23.12. 2004	Për dhënien e licencave për aktivitetin e eksport–importit të energjisë elektrike shoqërisë KESH sh.a.....	7227
Vendim i ERE nr.58, datë 28.12.2004	Për miratimin e kodit të sistemit të transmetimit (Kodi i funksionimit të rrjetit të transmetimit).....	7227
Vendim i ERE nr.59, datë 29.12.2004	Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike.....	7228
Vendim i ERE nr.60, datë 29.12.2004	Për miratimin e të dhënave bazë në lidhje me aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga prodhuesit e vegjël.....	7228

Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të BSH nr.84, datë 28.12.2004	Për shtesën e disa veprimtarive të lejuara për bankën “Raiffeisen sh.a.”	7229
	Shpallje kërkesë për shpronësim me objekt shpronësimin e pronarëve që preken nga ndërtimi i nënstacionit 110/6 kV Mamurras.....	7229
	Kërkesë për shpallje të zhdukur të shtetasit Panajot Malush Qamo.	7230

VENDIM
Nr.166, datë 16.12.2004

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 75 pika 2 të Kushtetutës dhe të nenit 172 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit,

KUVENDI
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Kjo Rregullore hyn në fuqi më 17 janar 2005, me përjashtim të pikës 2 të nenit 44, e cila hyn në fuqi më 1 maj 2005.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

VENDIM
Nr.908, datë 29.12.2004

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
INSPEKTORATIT TË INSTITUTEVE PRIVATE TË PENSIONEVE SUPLEMENTARE
DHE PËR PROCEDURAT E LICENCIMIT E TË MBIKËQYRJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 44 e 45 të ligjit nr.7943, datë 1.6.1995 “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Instituteve Private të Pensioneve Suplementare dhe për procedurat e licencimit e të mbikëqyrjes”, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

RREGULLORE
PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E INSPEKTORATIT TË INSTITUTEVE TË
PRIVATE TË PENSIONEVE SUPLEMENTARE DHE PËR PROCEDURAT E LICENCIMIT E
TË MBIKËQYRJES

KAPITULLI I PARË
TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Inspektorati i Instituteve Private të Pensioneve Suplementare, i cili, në nenet vijuese të kësaj rregulloreje, do të përdoret me termin IIPPS, është person juridik publik, i cili ushtron funksionet e veta në përputhje me ligjin nr.7943, datë 1.6.1995 “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”, të ndryshuar, si dhe me aktet e tjera, ligjore e nënligjore, të nxjerra në bazë e për zbatim të tij.

Neni 2

Objekti kryesor i veprimtarisë

2.1 IIPPS-ja ka si objekt kryesor të veprimtarisë zbatimin e ligjit për mbrojtjen e interesave të të siguruarve, të kontribuesve dhe të përfituesve në institutet private të pensioneve suplementare.

2.2 IIPPS-ja është autoriteti i vetëm që ushtron kompetencat për:

a) dhënien e lejes për ushtrimin e veprimtarisë së institutive private të pensioneve suplementare;

b) nxjerrjen e akteve që rregullojnë veprimtarinë e instituteve private të pensioneve suplementare.

c) mbikëqyrjen e veprimtarisë së institutive private të pensioneve suplementare;

d) fillimin dhe ndjekjen e procedurave për mbylljen ose falimentimin e veprimtarisë së instituteve private të pensioneve suplementare.

2.3 IIPPS-ja përgatit dhe, sipas rregullave në fuqi, dërgon për miratim në Këshillin e Ministrave akte ligjore dhe nënligjore për fushën e pensioneve private suplementare.

Neni 3

Terma shpjegues

Termet vijues do të kuptohen në çdo rast sipas përmbajtjes që përcaktohet në këtë nen:

a) “Licencim” nënkupton procesin e shqyrtimit të kërkesave për të ushtruar veprimtari si institut privat pensionesh suplementare.

b) “Leje” nënkupton aktin zyrtar të lëshuar nga IIPPS-ja, sipas një formati të përcaktuar në formularët që i bashkëlidhen kësaj rregulloreje.

c) “Administrim” nënkupton veprimtarinë tërësore që zhvillon një institut privat pensionesh suplementare.

Neni 4

Organizimi i IIPPS-së

IIPPS-ja është një institucion në varësi të Këshillit të Ministrave me funksione të përfaqësimit, të vendimmarrjes, të drejtimit dhe të raportimit. Struktura organizative e IIPPS-së përcaktohet me urdhër të Kryeministrit.

Neni 5 **Drejtimi dhe administrimi**

5.1 IIPPS-ja drejtohet dhe administrohet nga:

- a) Kryeinspektori,
- b) bordi këshillmor.

5.2 Kryeinspektori emërohet nga Kryeministri. Ai përfaqëson IIPPS-në dhe drejton veprimtarinë e këtij institucioni.

5.3 Kryeinspektori ka këto kompetenca:

- a) miraton rregulloret dhe udhëzimet, që kanë të bëjnë me organizimin, administrimin dhe zbatimin e procedurave të veprimtarisë ligjore;
- b) miraton rregullat e veprimtarisë së brendshme të IIPPS-së;
- c) emëron punonjësit e IIPPS-së sipas vendeve të punës dhe strukturës së miratuar nga Këshilli i Ministrave;
- d) miraton përbërjen nominale dhe funksionimin e organit këshillues të IIPPS-së — “Bordi këshillimor”;
- e) raporton te Kryeministri çdo tre muaj dhe sa herë që i kërkohet për ecurinë e veprimtarisë së IIPPS-së, për propozimet e bëra, vendimet e marra dhe zbatimin e tyre.

Neni 6 **Bordi këshillimor**

6.1 Bordi këshillimor është organ këshillues dhe në përbërje të tij marrin pjesë:

- a) drejtuesit e sektorëve të IIPPS-së;
- b) një përfaqësues nga Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale;
- c) një përfaqësues nga Ministria e Financave;
- d) dy anëtarë të tjerë me përvojë në fushën e sigurimeve shoqërore.

6.2 Bordi këshillimor ushtron vetëm funksione këshilluese. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të tij përcaktohet me rregullore të miratuar nga Kryeinspektori.

Neni 7 **Buxheti i IIPPS-së**

7.1 Viti financiar i IIPPS-së është vit i plotë kalendarik, i cili fillon më datë 1 janar dhe përfundon më datë 31 dhjetor.

7.2 IIPPS-ja ka buxhetin e vet, i cili përbëhet nga:

- a) të ardhurat,
- b) shpenzimet.

7.3 Të ardhurat e IIPPS-së përbëhen nga:

- a) kontributet e instituteve private të pensioneve suplementare, të cilat arrijnë deri në kufirin 1 (një) për qind të të ardhurave nga veprimtaria e tyre;
- b) të ardhurat nga shërbimet suplementare të kryera për institutet private të pensioneve, sipas tarifave të përcaktuara në legjislacionin shqiptar;
- c) të ardhurat nga sanksionet, në zbatim të ligjit nr.7943, datë 1.6.1995 “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”, të ndryshuar;
- d) të ardhurat e mbartura nga viti paraardhës;
- e) çdo e ardhur tjetër e mundshme, sipas legjislacionit shqiptar;
- f) nga Buxheti i Shtetit, kur burimet e mësipërme të të ardhurave nuk mjaftojnë.

7.4 IIPPS-ja përdor të ardhurat e realizuara për përballimin e shpenzimeve për funksionimin e tij, sipas buxhetit të miratuar nga Këshilli i Ministrave për:

- a) paga dhe shpërblime;
- b) sigurime shoqërore dhe shëndetësore të detyrueshme, si dhe sigurime shtetërore suplementare;

- c) shpenzime administrative;
- d) investime;
- e) trajnime e kualifikime;
- f) shpenzime udhëtimesh dhe dieta, brenda dhe jashtë vendit;
- g) kuotizacione anëtarësie në organizmat vendase apo ndërkombëtare.

7.5 Këshilli i Ministrave cakton pagën e Kryeinspektorit dhe të punonjësve të tjerë të IIPPS-së.

Neni 8 **Kontabiliteti**

8.1 IIPPS-ja mban veprimet kontabile në përputhje me ligjin “Për kontabilitetin”, si dhe me skemën e sigurimeve shoqërore, duke zbatuar të gjitha detyrimet ligjore, sipas rregullave të përcaktuara.

8.2 Veprimet kontabile duhet të pasqyrojnë në çdo kohë me saktësi gjendjen financiare të IIPPS-së.

8.3 IIPPS-ja përgatit çdo vit raportin vjetor, ku pasqyrohet veprimtaria financiare të cilin Kryeinspektori ia paraqet Kryeministrit brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.

KAPITULLI I DYTË FUNKSIONET E IIPPS-SË

Neni 9 **Vendimarrja**

IIPPS-ja merr vendime në përputhje me ligjin nr.7943, datë 1.6.1995 “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”, të ndryshuar, për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me dhënien e lejes për ushtrimin e veprimtarisë së instituteve private të pensioneve, për falimentimin dhe likuidimin e tyre, si dhe për rastet që i përkasin organizimit të brendshëm të strukturave të tyre.

Neni 10 **Leja për ushtrim veprimtarie**

IIPPS-ja është autoriteti i caktuar nga ligji nr.7943, datë 1.6.1995 “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”, të ndryshuar, për të ushtruar të drejtën e:

- a) dhënies së lejes për ushtrimin e aktivitetit si institut privat pensionesh;
- b) refuzimit të kërkesës për ushtrimin e aktivitetit si institut privat pensionesh;
- c) tërheqjes së lejes.

Neni 11 **Mbikëqyrja dhe kontrolli financiar**

IIPPS-ja ka të drejtë të mbikëqyrë dhe të kontrollojë periodikisht, në çdo kohë, subjektet e licencuara prej saj, si dhe të kërkojë e të verifikojë çdo informacion, të cilin e konsideron të nevojshëm për ushtrimin e funksioneve të ngarkuara me ligj.

Neni 12 **Bashkëpunimi me institucione të tjera**

12.1 IIPPS-ja krijon marrëdhënie bashkëpunimi me institucione të tjera në Republikën e Shqipërisë, duke këmbyer informacione dhe lidhur marrëveshje në shërbim të realizimit të funksioneve që i ngarkon ligji.

13.2 IIPPS-ja, në ushtrimin e veprimtarisë së ngarkuar nga ligji, krijon marrëdhënie bashkëpunimi me institucione analoge dhe organizma të tjera ndërkombëtare, duke nisur dhe zbatuar projekte të ndryshme, duke këmbyer informacione dhe lidhur marrëveshje, të cilat i shërbejnë integritetit dhe zhvillimit institucional.

Neni 13

Sistemi i informacionit dhe publikimet

13.1 IIPPS-ja krijon dhe administron strukturat dhe format e këmbimit e të raportimit të informacionit me subjektet që licencën dhe mbikëqyr, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Mënyra e ruajtjes dhe e administrimit të këtij informacioni përcaktohet me udhëzim të miratuar nga IIPPS-ja.

13.2 IIPPS-ja publikon buletinin e vet periodik, ku pasqyrohen vendimet e marra në lidhje me aktet rregullatore, njoftimet e ndryshme, të dhënat statistikore, analiza dhe/ose studime për sistemin e pensioneve suplementare, si dhe ekzaminimet e bëra në institutet private të pensioneve.

13.3 IIPPS-ja boton në Fletoren Zyrtare të gjitha vendimet për dhënien, kufizimin, heqjen e lejes për ushtrimin e veprimtarisë ose për fillimin e procedurave të falimentimit në fushën e sigurimit të pensioneve private.

KAPITULLI I TRETË

LEJA PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUTEVE PRIVATE TË PENSIONEVE SUPLEMENTARE

Neni 14

Krijimi i instituteve private të pensioneve suplementare

Instituti Privat i Pensioneve Suplementare krijohet si person juridik privat dhe vepron si një shoqëri tregtare. Emri i tij përcaktohet në statutin e shoqërisë dhe shoqërohet nga fjalët “Instituti privat pensionesh”.

Neni 15

Dokumentacioni i nevojshëm, që paraqitet pranë IIPPS-së

15.1 Dokumentacioni që paraqitet pranë IIPPS-së për hapjen e veprimtarisë si institut privat pensionesh suplementare, duhet të jetë i plotësuar në gjuhën shqipe në tekstin origjinal dhe, në mungesë, fotokopjen e noterizuar të tij.

15.2 Kërkesa për marrjen e lejes për krijimin e institutit privat të pensioneve suplementare, e cila ka në përmbajtje të dhënat e parashikuara në pikën 2 të nenit 13 të ligjit, duhet të shoqërohet nga:

- a) një deklaratë ose marrëveshje për qëllimin për të krijuar institutin privat të pensioneve suplementare;
- b) një deklaratë që përcakton numrin minimal të të punësuarve apo të të siguruarve të interesuar;
- c) modeli i kontratës së pjesëmarrësve në institutin privat të pensioneve suplementare;
- d) kontrata e aderimit të punëdhënësve, themelues dhe/ose jothemelues së tij.
- e) statuti i institutit privat të pensioneve suplementare;
- f) rregullorja e pensioneve;
- g) rregullorja financiare;
- h) plani i biznesit për pesë vitet e para;
- i) masat administrative e financiare që do të merren për funksionimin e rregullt të institutit privat të pensioneve suplementare;
- j) vërtetimin për pagesën e sigurimeve të detyrueshme shoqërore nga themeluesit ose jothemeluesit;

k) formularët, që përcaktojnë përmbajtjen e dokumenteve, të cilat i paraqiten IIPPS-së për marrjen e lejes për ushtrimin e veprimtarisë si institut privat pensionesh, i bashkëlidhen kësaj rregulloreje dhe bëhen pjesë e saj.

15.3 Dokumentacioni i nevojshëm që paraqitet pranë IIPP-së për burimin e kapitalit, përcaktohet në formularët bashkëlidhur rregullores.

Neni 16

Kërkesa për marrjen e lejes

16.1 Kërkesa për marrjen e lejes për të kryer veprimtari të caktimit dhe të administrimit të pensioneve bëhet me shkrim dhe paraqitet pranë IIPPS-së. Në përmbajtjen e kësaj kërkesë të deklarohet angazhimi për zbatimin e legjislacionit shqiptar gjatë veprimtarisë së ardhshme të institutit privat të pensioneve, emri i tij i propozuar.

16.2 IIPPS-ja mund të kërkojë ndryshimin e emërimit të institutit të propozuar, kur ky krijon një konfuzion në publik ose midis instituteve ekzistuese.

16.3 Kërkesa për marrjen e lejes duhet të shoqërohet me të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas ligjit nr.7943, datë 1.6.1995 “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”, të ndryshuar, dhe formularëve bashkëlidhur, si dhe atë të përcaktuar nga këto rregulla. Kërkesa si më sipër paraqitet e nënshkruar nga themeluesit e institutit të propozuar.

Neni 17

Kapitali fillestar dhe burimet e tij

17.1 Pas plotësimit të dokumentacionit të kërkuar nga IIPPS-ja për dhënien e lejes për të kryer aktivitet si institut privat pensionesh suplementare, themeluesit kryejnë pagesën e shumës së kapitalit fillestar minimal.

17.2 Pagesa e shumës së kapitalit fillestar minimal për kontributin në para, bëhet në monedhën shqiptare (Lek).

17.3 Kapitali fillestar i paguar (për kontributin në lek) për të marrë lejen, për të kryer veprimtari si institut pensionesh depozitohet në njërën nga bankat e nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë, në një llogari, depozitë e marrë si garanci (pa interes).

17.4 Organizimi i kontabilitetit bëhet mbështetur në ligjin “Për kontabilitetin”, në “Manualin e kontabilitetit”, miratuar me vendimin nr.820, datë 30.12.1998 të Këshillit të Ministrave, si dhe në standardet e mbajtjes së llogarive, sipas skemës së sigurimit të detyrueshëm shoqëror.

Neni 18

Krijimi i kushteve të organizimit të institutit të pensioneve

Themeluesit e institutit privat të pensioneve suplementare, bashkë me kërkesën për leje për ushtrimin e veprimtarisë, njoftojnë me shkrim IIPPS-në për përfundimin dhe realizimin e të gjitha kushteve të përcaktuara në formularët përkatës, bashkëlidhur.

Neni 19

Verifikimi i dokumenteve dhe afatet

19.1 IIPPS-ja bën verifikimin e plotësimit të dokumenteve të paraqitura në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij.

19.2 Data e pranimit të kërkesës për leje ushtrimi veprimtarie si institut privat pensionesh, konsiderohet data kur kërkuuesi ka plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara në ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Kjo datë i njoftohet me shkrim kërkuarit.

19.3 Dokumentacioni që paraqitet në IIPPS për marrjen e lejes për ushtrim veprimtarie si institut privat pensionesh, duhet të pasqyrojë të dhëna aktuale për periudha jo më të hershme se

muaji paraardhës. Në rastet kur dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë, nuk përmbush kërkesat ligjore dhe nënligjore, kërkesit i dërgohet një njoftim për mangësitë, duke i kërkuar plotësimin e tyre brenda një afati prej 60 ditësh.

19.4 ITPPS-ja, brenda 60 ditëve nga data e këtij njoftimi, jep ose refuzon lejen dhe njofton me shkrim kërkesin për vendimin e saj.

Neni 20

Refuzimi i kërkesës për leje dhe plotësimi i dokumentacionit

IIPPS-ja refuzon kërkesën në rastet:

a) kur nuk përmbushen kushtet dhe kërkesat për krijimin e institutit të pensioneve, të përcaktuara në nenet 11, 12 dhe 13 të ligjit nr.7943, datë 1.6.1995 “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”, të ndryshuar;

b) kur rregullorja e pensioneve, rregullorja financiare dhe masat administrative e organizative nuk sigurojnë aftësinë paguese të institutit të pensioneve;

c) kur deklarata ose marrëveshja e qëllimit, statuti, rregullorja e pensioneve dhe ajo financiare nuk përmbushin kërkesat e vendosura në ligjin nr.7943, datë 1.6.1995 “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”, të ndryshuar;

d) kur ndonjë nga themeluesit nuk ka paguar kontributet e sigurimit të detyrueshëm shoqëror.

Neni 21

Shqyrtimi i kërkesës për leje

21.1 IIPPS-ja shqyrton kërkesën e paraqitur për marrjen e lejes për ushtrim veprimtarie si institut privat pensionesh suplementare dhe merr vendim për pranimin ose refuzimin e saj, pasi:

a) ka analizuar të gjithë informacionin e siguruar, nëpërmjet materialit të paraqitur, duke bërë sipas rastit edhe verifikime;

b) ka organizuar takime me bordin drejtues të propozuar të institutit për të diskutuar objektivat e këtij instituti në treg, planbiznesin e paraqitur, kapitalizimin e propozuar të institutit, organizimin e tij, projektet financiare të institutit për të vitet e ardhshme, politikat kryesore të propozuara etj.;

c) ka vlerësuar të gjithë dokumentacionin e paraqitur, duke konsideruar edhe takimin e organizuar dhe sigurohet nëse pjesëtarët e bordit drejtues dhe të stafit ekzekutiv, të propozuar, të institutit privat të pensioneve suplementare janë të aftë profesionalisht;

d) ka shqyrtuar transparencën e burimeve dhe të strukturës së kapitalit aksioner të institutit;

e) ka vlerësuar, në bazë të planbiznesit të paraqitur, të rejtat, që do të sjellë instituti në treg, si dhe parashikimin e mbijetesës së tij në kushtet ekzistencës së konkurrencës së lirë në treg;

f) ka vlerësuar strukturën organizative të institutit të propozuar;

g) ka vlerësuar planbiznesin e paraqitur, nëse ai është real dhe bindës;

h) ka analizuar të ardhurat e parashikuara të institutit, duke synuar që instituti të jetë me fitim të programuar, brenda periudhës pesëvjeçare;

i) ka vlerësuar dhe ka verifikuar (nëse ka patur të tilla) opinionet e dhëna nga publiku për kërkesën e paraqitur;

j) ka vlerësuar mundësinë e aksionerëve të propozuar të institutit për të shtuar kapitalin, në qoftë se do të jetë i nevojshëm për të mbuluar humbjet që mund të rezultojnë nga ushtrimi i veprimtarisë si institut pensionesh.

21.2 IIPPS-ja, para dhënies së lejes, organizon një verifikim në vend të kushteve në të cilat instituti do të zhvillojë aktivitetin, për të përcaktuar nëse janë kryer përgatitjet e nevojshme për fillimin e tij. Verifikimi ka për qëllim të vlerësojë nëse:

a) instituti ka krijuar kushte për administrimin e aktivitetit;

b) disponon materialet e printuara, të nevojshme për kryerjen e aktivitetit të pensioneve;

c) është krijuar infrastruktura e nevojshme e teknologjisë së informacionit;

d) janë krijuar kushte për transparencën e plotë dhe shërbimin ndaj klientit.

Neni 22 Vendimi

22.1 Nëse kërkesat dhe kushtet e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore plotësohen dhe nga verifikimi i tyre vërehet se ekzistojnë mundësitë për të ushtruar veprimtarinë si institut privat pensionesh suplementare, IIPPS-ja merr vendim për dhënien e lejes brenda afatit 60-ditor nga data e dorëzimit të dokumentacionit të përfunduar.

22.2 Vendimi për dhënien e lejes për të ushtruar veprimtari si institut privat pensionesh suplementare në mbështetje të nenit 14 pika 1 të ligjit nr.7943, datë 1.6.1995 “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”, të ndryshuar, i bëhet i njohur, me shkrim, kërkuarit brenda një afati prej pesë ditësh pune nga data e marrjes së vendimit, së bashku me arsyet përkatëse.

Neni 23 Publikimi

Dhënia e lejes për të vepruar si institut privat pensionesh suplementare, publikohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë në “Buletinin zyrtar” të IIPPS-së, si dhe në një ose me shumë nga gazetatat me tirazh më të madh.

Neni 24 Tërheqja e lejes

24.1 IIPPS-ja tërheq një leje të dhënë më parë për ushtrim veprimtarie si institut privat pensionesh, kur vërtetohen rastet e përshkruara më poshtë:

- a) kërkohej nga vetë instituti i licencuar;
- b) kur kushtet për veprimtarinë e institutit të pensioneve, të përcaktuara në ligjin nr.7943, datë 1.6.1995 “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”, të ndryshuar, janë shkelur rëndë dhe nuk mund të rregullohen në rast se:
 - b.1. një subjekti themelues (institucion financiar ose jo) i është pakësuar ose ndaluar veprimtaria;
 - b.2. instituti nuk ka filluar veprimtarinë brenda afatit të parashikuar në autorizimin e dhënë ose ka ndërprerë për më shumë se 3 muaj veprimtarinë e përfundimit të kontratave me kontribuesit, si dhe të pranimin dhe të grumbullimit të kontributeve.
- c) kur rregullorja e pensioneve dhe statuti i institutit të pensioneve janë shkelur në mënyrë të tillë që instituti i pensioneve nuk mund të sigurojë më aftësinë paguese, përfshirë edhe rastet kur veprimtarinë e institutit ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga ato të paraqitura në kërkesën për lejen dhe nëse IIPPS-ja gjykon se një shmangie e tillë nuk përlligjet nga ndryshimet në rrethanat ekonomike.

24.2 IIPPS-ja vendos për tërheqjen e lejes të institutit brenda 30 ditëve pas marrjes së kërkesës me shkrim nga përfaqësuesi i autorizuar i institutit të pensioneve ose pas konstatimit të shkeljeve të bëra nga instituti privat i pensioneve suplementare, gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

24.3 Vendimi për tërheqjen e lejes dhe për mbylljen e veprimtarisë hyn në fuqi në datën e përcaktuar nga IIPPS-ja dhe publikohet në Fletoren Zyrtare në “Buletinin zyrtar” të IIPPS-së, si dhe në një ose më shumë nga gazetatat me tirazh më të madh.

24.4 Vendimi i IIPPS-së për tërheqjen e lejes i komunikohet me shkrim institutit të pensioneve brenda 5 (pesë) ditëve, duke parashtruar edhe arsyet e tërheqjes.

Neni 25

Veprimtaria e institutit pas tërheqjes së lejes

25.1 Instituti ndalohet të angazhohet në veprimtari financiare pas hyrjes në fuqi të vendimit të tërheqjes së lejes dhe detyrohet të likuidojë, sa më parë që të jetë e mundur, aktivet e veta, të zgjidhë marrëdhëniet kontraktore me kontribuesit dhe të shlyejë detyrimet.

25.2 Gjatë kësaj periudhe, veprimtaria e mëtejshme e institutit privat të pensioneve i nënshtrohet zbatimit të dispozitave, që parashikohen në legjislacionin përkatës për falimentimin.

Neni 26

Regjistrimi në IPPS

26.1 Në mbështetje të ligjit nr.7943, datë 1.6.1995 “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”, të ndryshuar, IPPS-ja mban një regjistër, ku regjistrohen të gjitha lejet e dhëna për ushtrim veprimtarie si institut privat pensionesh suplementare, të dhëna sipas kësaj rregulloreje.

26.2 Mënyra e plotësimit dhe e administrimit të tij përcaktohet me udhëzim të IPPS-së.

26.3 Në rastet e revokimit të autorizimit bëhet dhe çregjistrimi nga regjistri i fondeve të pensioneve suplementare dhe plotësuese.

26.4 Një listë e autorizimeve të revokuara mbahet në një tjetër regjistër të veçantë.

Neni 27

E drejta për zgjerimin ose për pakësimin e rrjetit të institutit të pensioneve

27.1 Çdo institut privat pensionesh ka të drejtë të hapë degë, agjenci ose zyra përfaqësimi të reja, nëse kjo veprimtari është në përputhje me statutin e tij, duke njoftuar me shkrim IPPS-në.

27.2 Në të njëjtën mënyrë, instituti privat i pensioneve njofton IPPS-në edhe për pakësim të rrjetit të degëve, agjencive ose zyrave të përfaqësimit.

Neni 28

Bashkimi ose ndarja e institutit privat të pensioneve suplementare

28.1 Në rast se një institut privat pensionesh suplementare kërkon të bashkohet me një tjetër institut privat pensionesh suplementare ose ta ndajë aktivitetin, duke krijuar një tjetër institut privat pensionesh suplementare, duhet t’i drejtojë një kërkesë me shkrim IPPS-së, ku të sqarohen arsyet e bashkimit a të ndarjes. Vetëm pas marrjes së pëlqimit nga IPPS-ja, instituti privat i pensioneve suplementare lejohet të fillojë procedurat për të ndërmarrë veprimet e nevojshme për bashkimin apo ndarjen e aktivitetit.

28.2 Për rastet kur bashkimet ose ndarjet çojnë në krijimin e një instituti të ri pensionesh, ky i fundit do t’u nënshtrohet të gjitha rregullave për licencimin si i tillë, në bazë të neneve 11, 12, 13 e 14 të ligjit nr.7943, datë 1.6.1995 “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”, të ndryshuar, dhe të dispozitave përkatëse të kësaj rregulloreje.

28.3 Afati maksimal për shqyrtimin e dokumentacionit dhe për miratimin ose për refuzimin e bashkimit a të ndarjes është 60 ditë nga plotësimi i dokumentacionit.

28.4 Edhe në këto raste, pas marrjes së vendimit për bashkimin ose për ndarjen e institutit, IPPS-ja publikon në Fletoren Zyrtare vendimin për bashkimin apo për ndarjen e aktivitetit e tij.

Neni 29

Transferimi i pronësisë mbi aksionet e një fondi pensionesh

29.1 Instituti privat i pensioneve, i cili kërkon të bëjë ndryshime në strukturën e aksionerëve të vet, pas miratimit të këtij ndryshimi nga asambleja e aksionerëve, i drejtohet IPPS-së për të marrë miratimin.

29.2 Transferimi i pronësisë mbi aksionet tek aksionerët e rinj, jashtë atyre ekzistues, bëhet vetëm pas miratimit të IIPPS-së.

29.3 Kërkesa që paraqitet në IIPPS shoqërohet me dokumentacionin, që përcakton burimin e kapitalit sipas formularëve, bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

29.4 Aksionari i ri i propozuar, duhet të deklarojë se do të ruajë interesat e klientëve të institutit dhe se fondet e destinuara për blerjen e aksioneve nuk burojnë nga hua, nga kredi dhe/ose nga paradhënie prej burimeve të tjera.

29.5 Pas plotësimit të dokumentacionit të kërkuar, IIPPS-ja shqyrton kërkesën e paraqitur për ndryshimin në listën e aksionarëve të institutit.

29.6 IIPPS-ja miraton ose refuzon transferimin e pronësisë mbi aksionet e institutit tek aksionerët e rinj, jashtë atyre ekzistues, jo më vonë se 60 ditë nga data kur dokumentacioni është paraqitur i plotë.

29.7 IIPPS-ja ka të drejtë ta publikojë vendimin e marrë për transferimin e pronësisë mbi aksionet e institutit.

KAPITULLI I KATËRT MBIKËQYRJA DHE KONTROLLI FINANCIAR

Neni 30 Qëllimi

30.1 Mbikëqyrja dhe kontrolli financiar i IIPPS-së për institutet private të pensioneve suplementare, siguron zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e pensioneve private suplementare.

30.2 Mbikëqyrja dhe kontrolli financiar i IIPPS-së, ka si qëllim që të sigurojë garancinë e nevojshme për të siguruarit në institutet private të pensioneve suplementare, që këto institute të ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore dhe në dobi të personave të siguruar.

Neni 31 Objekti

31.1 Objekti i mbikëqyrjes dhe kontrollit financiar të IIPPS-së është veprimtaria e instituteve private të pensioneve suplementare, e cila synon zbulimin dhe parandalimin e të metave e të parregullsive dhe marrjen e masave për rregullimin e tyre nëpërmjet:

a) kontrollit të vazhdueshëm dhe të gjithanshëm të aktivitetit tërësor dhe të respektimit të përgjegjësiave kontraktore ndaj kontribuesve dhe përfituesve në skemën e sigurimit privat të pensioneve;

b) zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë e institutit privat të pensioneve;

c) identifikimit të risqeve aktuale ose të mundshme në aktivitetin e institutit privat të pensioneve suplementare, si dhe të vlerësimit të aftësive menaxhuese dhe të performancës për administrimin e instituteve private të pensioneve suplementare.

31.2 IIPPS-ja ka të drejtë t'u kërkojë instituteve private çdo informacion e dokument që e çmon të nevojshëm për ushtrimin e kontrollit të veprimtarisë së institutit privat të pensioneve.

31.3 IIPPS-ja ka të drejtë të caktojë ekspertë të fushave të ndryshme, për realizimin e objektit të kontrollit.

31.4 IIPPS-ja ka të drejtë të ndryshojë ose të zgjerojë objektin e kontrollit, nëse gjatë këtij procesi vlerësohet e arsyeshme arritja e konkluzioneve sa më të drejta për institutet private të pensioneve.

Neni 32

Drejtimet kryesore të mbikëqyrjes dhe të kontrollit

32.1 Drejtimet kryesore të ushtrimit të veprimtarisë së mbikëqyrjes dhe kontrollit të IPPS-së do të fokusohen kryesisht në elementet e mëposhtme:

- a) mbikëqyrjen dhe vlerësimin e gjendjes financiare të institutit privat të pensioneve dhe aftësia e tij për pagimin e përfitimeve;
- b) mbikëqyrjen dhe vlerësimin e nivelit të garancisë, mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë së strukturës së kapitalit, si dhe përcaktimin e prognozave për të ardhmen;
- c) kontrollin e llogarive individuale, duke verifikuar elementet përbërëse të informacionit;
- d) vlerësimin e garancisë së instituteve private të pensioneve, në raport me interesat e të siguruarve.

32.2 IPPS-ja ka përgjegjësi për zbatimin e detyrave të mbikëqyrjes dhe të kontrollit në:

- a) pasqyrimin dhe vlerësimin e saktë të aktivitetit të institutit të pensioneve, objekt i këtij kontrolli;
- b) arritjen e konkluzioneve të sakta rreth gjendjes, aktuale dhe të ardhshme, të instituteve private të pensioneve suplementare dhe përcaktimin e rekomandimeve për përmirësimin e tyre.

Neni 33

Raporti i kontrollit

33.1 Rezultatet e kontrollit dokumentohen në raportin e kontrollit, të hartuar mbi bazën e konstatimeve të bëra gjatë kontrollit të veprimtarisë financiare të instituteve private të pensioneve suplementare.

33.2 Raporti përmban përshkrimin e situatës në mënyrë të përmbledhur, faktet e konstatuara, parregullsitë dhe propozimet për përmirësimin e situatës financiare.

33.3 Raporti i kontrollit i dërgohet për zbatim institutit privat të pensioneve suplementare.

33.4 IPPS-ja ndihmon në rregullimin e të metave të konstatuara, duke rekomanduar rrugët dhe mundësitë për riparimin e tyre.

33.5 IPPS-ja, përpara se të vendosë për marrjen e masave për rastin konkret, duhet të vlerësojë në mënyrë të kujdesshme vendimet e marra nga instituti privat i pensioneve suplementare, si dhe nëse ato janë në favor të interesave të aderuesve.

Neni 34

Konflikti i interesave

Inspektorët nuk duhet të kenë asnjë interes ose obligim financiar, që bie ndesh ose krijon konflikt interesi në veprimtarinë e IPPS-së ndaj instituteve private të pensioneve suplementare.

Neni 35

Masa organizative

IPPS-ja përgatit udhëzime praktike, që ndihmojnë në organizimin dhe zhvillimin me efektivitet të mbikëqyrjes dhe të kontrollit financiar, në funksion të përmbushjes së këtij qëllimi.

KAPITULLI I PESTË
LIKUIDIMI DHE FALIMENTIMI I INSTITUTIT PRIVAT
TË PENSIONEVE SUPLEMENTARE

Neni 36
Likuidimi

36.1 Nëse aksionarët e një instituti privat pensionesh suplementare vendosin vullnetarisht të mbyllin aktivitetin e institutit, duhet të njoftojnë IIPPS-në brenda një afati prej 10 ditësh nga data e marrjes së vendimit, për të filluar procesin e likuidimit.

36.2 IIPPS-ja mund të vendosë për kalimin në proces likuidimi të një instituti privat pensionesh suplementare në çdo rast, kur konstatohen shkeljet që përcaktohen në nenin 24 të kësaj rregulloreje.

Neni 37
Procedura për likuidim

37.1 IIPPS-ja vendos për fillimin e procedurave të likuidimit, brenda një afati prej 30 ditësh nga:

- a) data e marrjes së vendimit për tërheqjen e lejes;
- b) data e depozitimit të kërkesës për likuidim vullnetar.

37.2 Me marrjen e vendimit përkatës, IIPPS-ja depoziton një kërkesë për fillimin e procedurave të likuidimit në Gjykatën e Shkallës së Parë, Tiranë.

37.3 Pas hyrjes në fuqi të vendimit gjyqësor për fillimin e procedurave të likuidimit, si dhe të regjistrimit në regjistrin tregtar si shoqëri në likuidim, IIPPS-ja bën publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe në të paktën dy gazeta të përditshme, me tirazhin më të madh.

Neni 38
Caktimi i likuidatorit

38.1 Për kryerjen e procesit të likuidimit IIPPS-ja cakton likuidatorin.

38.2 Likuidatori vepron në emër të shoqërisë në likuidim, duke administruar aktivitetin likuidues, duke ndjekur përparësinë e detyrimeve të shoqërisë në likuidim dhe duke nënshkruar të gjitha aktet e saj.

38.3 Përparësia e detyrimeve të shoqërisë në likuidim përcaktohet në udhëzimin përkatës, të miratuar nga IIPPS-ja, në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe të dispozitave të kësaj rregulloreje.

38.4 Likuidatori duhet të përgatisë bilancin e shoqërisë për likuidim, si dhe një raport sqarues rreth tij, brenda një afati prej 30 ditësh nga data e fillimit të procedurave të likuidimit.

38.5 Gjatë kryerjes së procesit të likuidimit, likuidatori raporton me shkrim pranë IIPPS-së, lidhur me ecurinë e procedurave të likuidimit, jo më pak se një herë në muaj.

38.6 Procedurat e mëtejshme që kryhen nga likuidatori gjatë procesit të likuidimit, përcaktohen në udhëzimin e miratuar nga IIPPS-ja, në zbatim të kësaj rregulloreje.

Neni 39
Falimentimi

IIPPS-ja vendos, në çdo rast, fillimin e procedurave të falimentimit kur:

a) në bazë të raportit të njësisë së mbikëqyrjes vlerëson se gjatë administrimit të përkohshëm gjendja financiare e shoqërisë nuk është përmirësuar dhe shoqëria nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet ndaj të siguarve;

b) gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes së institutit privat të pensioneve suplementare, konstatohet se aktiviteti i tij janë të pamjaftueshme për të përmbushur detyrimet e të siguarve;

- c) instituti privat i pensioneve suplementare mund të ndodhet në gjendjen e mbingarkesës me borxhe dhe nuk ka mundësi të vazhdojë veprimtarinë për të përmbushur detyrimet ndaj aderuesve;
- d) Asambleja e Përgjithshme e refuzon rritjen e kapitalit themelues të institutit privat të pensioneve.

Neni 40

Procedura për fillimin e procesit të falimentimit

40.1 IIPPS-ja paraqet në gjykatë kërkesën për fillimin e procedurave të falimentimit, brenda pesë ditëve nga data e marrjes së vendimit.

40.2 Të drejtën për të kërkuar nga gjykata fillimin e procedurave të falimentimit e kanë edhe aksionarët apo likuidatorët e institutit privat të pensioneve suplementare. Aksionarët apo likuidatorët e institutit privat të pensioneve suplementare paraqesin pranë IIPPS-së një kopje të kërkesës për fillimin e procedurave të falimentimit, jo më vonë se 3 (tri) ditë nga data e regjistrimit të saj në gjykatë.

40.3 Për ndjekjen e veprimeve të mëtejshme të falimentimit, IIPPS-ja zbaton procedurat e përcaktuara në nenet 24, 25 e 39 të kësaj rregulloreje.

KAPITULLI I GJASHTË DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 41

Sanksionet

41.1 Gjatë ushtrimit të aktivitetit të një instituti privat pensionesh suplementare, kur IIPPS-ja konstaton shkelje të rregullores së pensioneve, të rregullores së kontributeve, të statutit ose përdorim jo të rregullt të fondeve, ka të drejtë të caktojë sanksionet e mëposhtme:

- a) të pezullojë përkohësisht nënshkrimin e një kontrate të re të institutit, me çdo person të siguruar ose që kërkon të sigurohet;
- b) të kufizojë veprimtarinë e institutit nëpërmjet kufizimit të lejes për ushtrim veprimtarie;
- c) të shpërndajë Asamblenë e Përgjithshme dhe të propozojë masat e nevojshme, që duhen marrë për funksionimin e duhur të institutit;
- d) të vendosë gjoba, konform dispozitave ligjore;
- e) të autorizojë mbylljen e institutit të pensioneve;
- f) të vendosë për likuidimin dhe të caktojë likuidatorin e institutit të pensioneve.

41.2 Instituti i pensioneve mbyll veprimtarinë vetëm me miratimin e IIPPS-së në rastet kur:

- a) është deklaruar falimentimi i institutit;
- b) integrohet në një institut tjetër pensionesh;
- c) ndahet në më tepër se një institut pensionesh;
- d) nuk ka vazhdimësi ligjore.

41.3 Në rastet e mësipërme, të gjitha të drejtat e fituara nga të siguruarit kompensohen nga instituti i pensioneve.

Neni 42

Ankimi ndaj vendimeve të IIPPS-së

Çdo institut privat pensionesh, ka të drejtë të ushtrojë ankim ndaj akteve që nxjerr IIPPS-ja, në përputhje me parashikimet e dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative, për ato raste kur çmohet se IIPPS-ja ka vepruar në kundërshtim apo tejkalim të kompetencave, që përcaktohen nga ligji nr.7943, datë 1.6.1995 “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”, të ndryshuar, si dhe të akteve të tjera nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë e instituteve private të pensioneve suplementare në Republikën e Shqipërisë.

Neni 43
Komisionet

43.1 Shpenzimet e çdo natyre për mbikëqyrjen nga IIPPS-ja të veprimtarisë së administrimit dhe caktimit të pensioneve, përballohen nga kontributet e instituteve private të pensioneve.

43.2 Kontributet paguhën në lekë, në llogarinë e IIPPS-së, brenda datës 10 të muajit pasardhës.

43.3 Në fund të çdo viti financiar, IIPPS-ja bën rakordimin përkatës të llogarive me institutet private të pensioneve.

43.4 Në çastin e paraqitjes së kërkesës për leje për ushtrim veprimtarie si institut privat pensionesh ose për zgjerim të aktivitetit, kërkuksi paguan në llogarinë e IIPPS-së një komision prej 200 000 lekësh.

43.5 Në çastin e dhënies së lejes për kryerjen e aktivitetit, për të cilin është bërë kërkesa, kërkuksi paguan në IIPPS një komision prej 300 000 lekësh.

43.6 Këto komisione janë të parimbursueshme.

Neni 44
Informimi i publikut

44.1 IIPPS-ja përgatit studime, analiza, rekomandime dhe udhëzime për zhvillimin e tregut në fushën e sigurimeve shoqërore, për ta mbajtur atë të qëndrueshëm, transparent dhe efikas.

44.2 IIPPS-ja ka të drejtë të publikojë në media dhe në organet e specializuara studime, analiza, informacione dhe të dhëna të tjera me karakter statistikor, të cilat kanë qëllim njohjen e publikut me zhvillimet e funksionimit të skemave të pensioneve private suplementare në Republikën e Shqipërisë.

44.3 IIPPS-ja ka të drejtë të organizojë edhe aktivitete të tjera, me karakter informues, si takime, konferenca, seminare etj.

KËRKESË

Për Inspektoratin e Instituteve Private të Pensioneve Suplementare

Për dhënien e lejes zyrtare një instituti privat pensionesh suplementare

Emri i institutit të propozuar: _____

(Vendndodhja e propozuar : Adresa)

/ _____ / _____ / _____
(Qyteti) (Rrethi) (Prefektura)

Të dhëna të përgjithshme

Përpara përgatitjes dhe dërgimit të kësaj kërkesë sugjerohet që subjekti (subjektet) i interesuar të lexojë me vëmendje ligjin nr.7943, datë 1.6 .1995 “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve, të ndryshuar, rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Instituteve Private të Pensioneve Suplementare dhe për procedurat e licencimit e të mbikëqyrjes”, si dhe me aktet e tjera, ligjore e nënligjore, sipas të cilave do të zhvillohet procedura e përgatitjes së kërkesës për dhënien e lejes.

Për fillimin e procedurave të licencimit duhet të paraqisni dokumentet origjinale, të përcaktuara, si dhe dy kopje të kërkesës.

Adresa

Inspektorati i Instituteve Private të Pensioneve Suplementare

.../Tiranë

Tel/Fax _____ / _____

FORMULAR NR. 1

(Emri i shoqërisë së propozuar)

DEKLARATË

Në deklaratë subjekti i interesuar duhet të theksojë qëllimin e krijimit. Kur janë disa subjekte, nënshkruajnë të gjithë, si dhe përcaktojnë punëdhënësin që do t'i jepet e drejta e përfaqësimit të të gjitha palëve të interesuara. Në mënyrë të veçantë, të jepen të gjitha garancitë, që respektojnë ligjin dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore, të cilat lidhen me fushën e pensioneve private suplementare.

- Emri i institutit privat të pensioneve suplementare

- Vendndodhja e institutit

- Themeluesit

Nr.	Subjekti	Adresa	Telefon/fax	

- Veprimtaria e institutit privat të pensioneve suplementare

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____

- Përmbushim detyrimin për mbulimin e shpenzimeve për krijimin e institutit të pensioneve.

- Vlera minimale e një aksioni do të jetë _____

lekë. (me shifra dhe me fjalë)

- Garancia do të mblidhet dhe do të depozitohet në bankë, në numrin e llogarisë _____

- Parashikimi për shpenzimet e pritshme të institutit privat të pensioneve:

- 1. _____ lekë
- 2. _____ lekë
- 3. _____ lekë
- 4. _____ lekë
- 5. _____ lekë

TOTALI

FORMULAR NR. 2
INFORMACION
PËR AKSIONARËT E INSTITUTIT PRIVAT TË PENSIONEVE SUPLEMENTARE
Vlera e një aksioni sipas statutit _____

Nr.	Emri i plotë i subjektit punëdhënës	Nr.i aksioneve që zotëron	Vlera absolute	% e zotërimit ndaj totalit

Nënshkrimi i aksioneve nga përfaqësuesi i autorizuar i subjektit (subjekteve)

FORMULAR NR. 3
INFORMACION PËR ORGANET E INSTITUTIT PRIVAT TË PENSIONEVE
SUPLEMENTARE

A. Këshilli mbikëqyrës
B. Bordi drejtues
C. Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve
- Dhoma e aksionarëve
- Dhoma e përfaqësuesve të personave të siguruar
D. Ekspertët kontabël të autorizuar
Për secilin duhet të jepen këto të dhëna:
Emri, atësia, mbiemri
Shtetësia
Adresa e vendbanimit
Arsimi
Punësimi, i shkuar dhe aktual
Përvoja në veprimtarinë e sigurimeve shoqërore
Reputacioni

FORMULAR NR. 4
INFORMACION PËR THEMELUESIT E INSTITUTIT PRIVAT TË
PENSIONEVE SUPLEMENTARE

Nr.	Emri, atësia, mbiemri i përfaqësuesit të subjektit punëdhënës	Kombësia	Shtetësia	Adresa e vendbanimit

Nënshkrimi i përfaqësuesve të subjekteve themeluese

FORMULAR NR. 5
INFORMACION PËR VENDNDODHJEN E INSTITUTIT PRIVAT TË
PENSIONEVE SUPLEMENTARE

Këtu jepen të dhëna për:

1 Ku mendohet të jetë vendndodhja e zyrave të institutit privat të pensioneve suplementare:

a. Adresa (rrethi, qyteti etj.).

b. Lloji i ndërtesës që mendohet.

c. Sipërfaqja në m².

d. Forma e posedimit: Do të jetë në pronësi të institutit apo do të merret me qira.

e. (Të jepet çmimi i blerjes apo i qirasë).

f. Nëse mendohet të ndërtohet një ndërtesë për institutin, të jepet informacion për punën, që po bëhet për të siguruar lejen dhe truallin.

2. Ku mendohet të jetë vendndodhja e degëve dhe e agjencive të institutit privat të pensioneve suplementare, shtrirja e tyre. Për secilën të jepen të dhëna, sipas pikës nr. 1.

FORMULAR NR. 6
STATUTI I INSTITUTIT PRIVAT TË PENSIONEVE SUPLEMENTARE

Sqarim. Statuti duhet të hartohet dhe të përmbajë të dhëna sipas ligjit nr. 7943, datë 1.6.1995 “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”, të ndryshuar. Statuti nënshkruhet prej anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve.

Emri, atësia, mbiemri

Nënshkrimi

FORMULAR NR. 7
AKTI I THEMELIMIT TË INSTITUTIT PRIVAT TË PENSIONEVE
SUPLEMENTARE

Shënim. Akti i themelimit duhet të nënshkruhet nga të gjithë përfaqësuesit e subjekteve punëdhënëse themeluese të institutit privat të pensioneve suplementare

FORMULAR NR. 8

Subjekti punëdhënës i interesuar duhet të paraqesë edhe:

1. Vërtetimin për derdhjen në llogari të kapitalit themeltar.
2. Planin e biznesit, i cili përmban:
 - numrin e personave pjesëmarrës në fond;
 - të ardhurat nga kontributet;
 - të ardhurat nga investimi i fondit;
 - shpenzimet paraprake, që do të ndërmarrë organizimi;
 - shumën, që do të shpenzojë për përfitimet;
 - koston administrative të menaxhimit të fondit.
3. Informacion për masat organizative dhe administrative për:
 - pajisjen e zyrave;
 - stafin e institutit privat të pensioneve suplementare;
 - teknologjinë e informacionit;
 - organizimin e menaxhimit.

FORMULAR NR.9
RAPORT FINANCIAR KONFIDENCIAL

Do të plotësohet nga çdo përfaqësues i subjekteve punëdhënëse, themeluese të kapitalit aksioner

GJENDJA FINANCIARE ME _____
(data)

Depozituar nga: _____

1. Emri i subjektit punëdhënës themelues, si dhe për përfaqësuesin shënohen:
Emri, atësia, mbiemri, data dhe vendi i lindjes, nënshtetësia dhe adresa e vendbanimit.

**PËR INSPEKTORATIN E INSTITUTEVE PRIVATE TË PENSIONEVE
SUPLEMENTARE**

Në lidhje me:

Burimet e kapitalit themeltar

Instruksione:

Përgjigjuni të gjitha pyetjeve, plotësisht. Nëse përgjigjja është “Jo” ose “Asnjë” ose “E pazbatueshme”, ju lutemi pasqyrojeni saktësisht. Të gjitha pasqyrat duhet të nënshkruhen dhe të datohen,

Një raport i pasaktë dhe i paplotë nuk pranohet dhe përbën shkak për refuzimin e kërkesës për leje.

Çdo faqe e informacionit në raportin financiar konfidencial duhet të nënshkruhet nga individ, që e plotëson atë, të datohet prej tij dhe të noterizohet te një noter publik.

Për të sqaruar ndonjë pyetje lidhur me këtë raport, personi që e plotëson mund të kontaktojë me personat e ngarkuar në Inspektoratin e Instituteve Private të Pensioneve Suplementare.

Shënim. Të gjitha të dhënat për kapitalet të jepen në lekë shqiptare

PËR BURIMET E KAPITALIT

Emri i subjektit punëdhënës _____

Të ardhura	200__	200__	200__	Vlera e vitit në vazhdim
Nga dividendët e fituar në aktivitete:	__lekë	__lekë	__lekë	__lekë
1. Nga huatë				
2. Nga dhurimet				
3. Të ardhura të tjera				
Totali i të ardhurave				

FORMULAR 9/1

Nga dividendët e fituat në aktivitete

Nr.	Emri i shoqërisë ku ka pronësi	Shuma e dividendit	200__	200__	200__	Vlera e vitit në vazhdim
	Totali					

FORMULAR 9/2

Nga huatë

Emri i huadhënësit	Niveli i interesit	Shuma	Garancia

FORMULAR 9/3

Nga dhurimet

Ky formular duhet të shoqërohet me aktin e dhurimit

Nr.	Emri i dhuruesit	Lidhja familjare	Shuma

FORMULAR 9/4

Të ardhura të tjera

CERTIFIKATË

Nëpërmjet së cilës unë, _____ deklaroj se informacioni i paraqitur është i vërtetë dhe i saktë. Ai pasqyron të gjitha pasuritë e detyrimet dhe nuk përmban fshehje të fakteve. Deklaroj, gjithashtu, se informacioni i dhënë paraqitet vullnetarisht dhe personalisht nga unë _____ në Inspektoratin e Instituteve Private të Pensioneve Suplementare.

Nëse nevojitet informacion financiar shtesë ose më i detajuar rreth deklarimeve të kërkuara nga Inspektorati i Instituteve Private të Pensioneve Suplementare, unë _____ do ta paraqes atë, si kërkohet.

(Data)

(Nënshkrimi)

(Adresa)

Plotësuar dhe nënshkruar në këtë datë nga unë noteri _____

Qyteti _____, me _____

(Nënshkrimi i noterit publik)

Shënim. Çdo paraqitje e gabuar ose lënie jashtë e fakteve në këtë raport mund të jetë shkak për refuzimin e kërkesës për licencim pranë Inspektoratit të Instituteve Private të Pensioneve Suplementare, dhe pasqyron ndershmërinë dhe personalitetin tim.

LEJE

Nr. _____, datë _____

**PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SI INSTITUT PRIVAT PENSIONESH
SUPLEMENTARE**

Mbështetur në ligjin nr.7943, datë 1.6.1995 “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”, të ndryshuar me ligjin nr.8393, datë 2.9.1998 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7943, datë 1.6.1995 “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”, të ndryshuar me ligjin nr.9181, datë 5.2.2004 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7943, datë 1.6.1995 “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”, të ndryshuar me ligjin nr.8393, datë 2.9.1998”, të vendimit nr.475, datë 22.7.1998 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Inspektoratit të Instituteve Private të Pensioneve Suplementare”, si dhe të vendimit nr.____, datë _____ të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Instituteve Private të Pensioneve Suplementare” dhe për procedurat e licencimit dhe të mbikëqyrjes”, Inspektorati i Instituteve Private të Pensioneve Suplementare

VENDOSI:

1. Të lejojë zhvillimin e veprimtarisë si institut privat pensionesh suplementare për subjektin

2. Subjekti _____, do ta fillojë veprimtarinë si institut privat pensionesh suplementare brenda datës _____.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEINSPEKTORI

VENDIM

Nr.909, datë 29.12.2004

**PËR MËNYRËN DHE KRITERET E RIMBURSIMIT TË BARNAVE PËR USHTARAKËT E
FORCAVE TË ARMATOSURA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 41 të ligjit nr.9210. datë 23.3.2004, “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes dhe të Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ushtarakëve aktivë të Forcave të Armatosura (oficerë, nënoficerë, ushtarë me pagesë/profesionistë), ushtarëve të shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv, oficerëve, që kanë dalë në rezervë dhe lirim, e vërtetuar kjo me dokumentin e “Identifikimit ushtarak”, iu rimbursohen në masën 80 për qind, për çdo alternativë, nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, barnat e listës së rimbursimeve.

2. Nëse për një grup barnash të caktuara ekziston një masë mbulimi më e madhe se 80 për qind, rimbursimi për kategoritë e parashikuara në pikën 1, të bëhet sipas listës së barnave, që rimbursohen nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, referuar alternativës së parë të barit.

3. Ushtarakëve, që dëmtohen gjatë operacioneve ushtarake ndërkombëtare, iu rimbursohen barnat në masën 100 për qind, deri në riaftësimin e tyre, sipas vërtetimit të institucionit shëndetësor, që ka kryer trajtimin e ushtarakut.

4. Ushtarakët, që dalin në lirim për shkak të dënimit me burg, për krime, me vendim gjykatë të formës së prerë, nuk përfitojnë rimbursim barnash.

5. Ministria e Mbrojtjes, nga buxheti i vet, derdh kontribute tek Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, për mbulimin e diferencës ndërmjet masës së mbulimit të çmimit të barnave, të përcaktuar në këtë vendim dhe masës së mbulimit të çmimit të alternativave, sipas listës së barnave, që rimbursohen nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.

6. Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, në zbatim të këtij vendimi, rimburson farmacitë e tregtimit me pakicë të barnave, të cilat kanë kontratë me të, për diferencën e çmimit, të përcaktuar në pikën 5, për kategoritë e ushtarakëve përfitues, vetëm kur ata identifikohen nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe vërtetohet me dokumentin “Identifikimi ushtarak”, se u përkasin këtyre kategorive, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi që derdh, çdo vit, për këtë qëllim, Ministria e Mbrojtjes në buxhetin e Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.

8. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financave dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga 1.11.2005.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr.912, datë 29.12.2004

PËR NJË SHITESË NË BUXHETIN E VITIT 2004, MIRATUAR PËR MINISTRINË E MBROJTJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Mbrojtjes, në buxhetin e miratuar për vitin 2004, në artikullin 602 “Mallra dhe shërbime të tjera”, t’i shtohet një fond prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh, për pajisjen e 1 (një) helikopteri, të tipit “AB-205”, për Forcat Ajrore të Republikës së Shqipërisë dhe vënien e tij në efikasitet, sipas programit të veçantë “Për pajisjen me helikopterë të Regjimentit të Helikopterëve”, të miratuar me vendimin nr.368, datë 5.6.2003 të Këshillit të Ministrave.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ministria e Mbrojtjes, nëpërmjet ndërmarrjes shtetërore “MEICO”, të hartojë, për këtë fond të konvertuar në USD, kontratën dypalëshe me shoqërinë “Augusta”, SpA, për realizimin e qëllimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM
Nr.56, datë 23.12. 2004

**PËR DHËNIEN E LICENCAVE PËR AKTIVITETIN E EKSPORT-IMPORTIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE SHOQËRISË KESH SHA**

Në mbështetje të ligjit 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neni 13 pika 1, germa d, dh, neni 15 pika 1, vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.27, datë 30.5.2004 “Rregullorja për procedurat e licencimit” neni 5 pika 1, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datë 23.12.2004, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) sh.a., për marrje të licencave për aktivitetin e eksportit dhe të importit të energjisë elektrike,

VENDOSI

1. Dhënien e licencës për aktivitetin e eksportit të energjisë elektrike shoqërisë KESH sh.a.
2. Dhënien e licencës për aktivitetin e importit të energjisë elektrike shoqërisë KESH sh.a.
3. Kohëzgjatja e vlefshmërisë së licencave sipas pikave 1 dhe 2 është deri me datë 31.12.2005.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

VENDIM
Nr.58, datë 28.12.2004

**PËR MIRATIMIN E KODIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT
(KODI I FUNKSIONIMIT TË RRJETIT TË TRANSMETIMIT)**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, germa i, nenit 42 dhe nenit 55 të ligjit nr.9072 datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2004, pasi shqyrtoi draftin e paraqitur nga Task-Forca e ngritur për përgatitjen e Kodit të Sistemit të Transmetimit (Kodit të Funkzionimit të Rrjetit të Transmetimit):

VENDOSI:

Miratimin e Kodit të Sistemit të Transmetimit (Kodit të Funkzionimit të Rrjetit të Transmetimit). (Kodi bashkëlidhur këtij vendimi).

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

VENDIM
Nr.59, datë 29.12.2004

**PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË LLOGARITJES SË TARIFAVE TË
TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 28 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.12.2004, pasi shqyrtoi draftin e paraqitur nga Departamenti i Tarifave dhe i Çmimeve për Metodologjinë e Llogaritjes së Tarifave të Transmetimit të Energjisë Elektrike,

VENDOSI:

Miratimin e Metodologjisë së Llogaritjes së Tarifave të Transmetimit të Energjisë Elektrike (Metodologjia bashkëlidhur këtij vendimi).

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

VENDIM
Nr.60, datë 29.12.2004

**PËR MIRATIMIN E TË DHËNAVE BAZË NË LIDHJE ME APLIKIMIN PËR ÇMIMIN E
SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA PRODHUESIT E VEGJËL**

Në mbështetje të nenit 28 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.12.2004, pasi shqyrtoi draftin e paraqitur nga Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve për të dhënat bazë në lidhje me aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga prodhuesit e vegjël,

VENDOSI:

Miratimin e të dhënave bazë në lidhje me aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga prodhuesit e vegjël. (Tabelat bashkëlidhur këtij vendimi).

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

VENDIM
Nr.84, datë 28.12.2004

PËR SHITESËN E DISA VEPRIMTARIVE TË LEJUARA PËR BANKËN
“RAIFFEISEN SHA”

Në mbështetje të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” neni 12 shkronja a, neni 43 shkronja c dhe të ligjit nr.8365, datë 2.7.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” neni 8, pika 2, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të miratojë shtesën e këtyre veprimtarive të lejuara në aneksin e licencës së bankës “Raiffeisen”, si më poshtë:

a) këmbimin e valutave duke përfshirë kontratat e së ardhmes (future) për këmbime valutore;

b) shërbime besimi (trust), përfshirë pa kufizim, investimin dhe administrimin e fondeve të besuara (fiduciare);

c) shërbime si administruese e portofolit të investimit ose të këshilltarit për investimet;

d) shërbime për nënshkrimin dhe për shpërndarjen e letrave me vlerë të borxhit dhe të pronësisë, si dhe tregtimin e letrave me vlerë të pronësisë për llogari të saj ose të klientëve, sipas kufizimeve të parashikuara në nenin 33 të ligjit nr.8365, datë 2.7.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

2. Banka “Raiffeisen” të njoftojë Bankën e Shqipërisë për nisjen e operacioneve të përfshira në këtë licencë, si edhe të dërgojë kuadrin e brendshëm rregullativ që përcakton mënyrën e kryerjes dhe të monitorimit të këtyre veprimtarive.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes me zbatimin e këtij vendimi.

4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ardian Fullani

SHPLLJE KËRKESË PËR SHPRONËSIM ME INTERES PUBLIK

Ministria e Industrisë dhe Energjetikës shpall kërkesën për shpronësim me interes publik të pasurive të paluajtshme të tipit “tokë bujqësore arë” që preken nga “Ndërtimi i nënstacionit elektrik 110/6 kV Mamurras”.

Subjekti kërkues i këtij shpronësimi është KESH sH.a Tiranë.

Me anën e këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJETIKËS

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË “NDËRTIMIT TË
NËNSTACIONIT 110/6 KV MAMURRAS”

RRETHI KURBIN
QYTETI MAMURRAS

Llogaria e pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: Tokë arë

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Zona kadastrale	Nr.pasurisë	Sipërfaqja e përgjithshme m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera e kompensimit në lekë
1.	Avni	Rustem	Pepa	Tokë arë	1676	438/27/4	2233.1	1 000	2 233 100
	Totali								2 233 100

KËRKESË

Shtetasja Liljana Qamo, e datëlindjes 27.10.1962, lindur në Mërtinj të Përmetit dhe banuese në Durrës, përfaqësuar me prokurë nga avokate Mirushe Çobo, kërkon shpalljen të zhdukur të bashkëshortit të saj Panajot Malush Qamo, i datëlindjes 12.5.1963, lindur në Katundisht të rrethit Përmet.

KËRKUESE
Liljana Qamo

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;

- Qendrës së Publikimeve Zyrtare;

Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".

Tel: 042 555 63; 267 468

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

BOTIMET:

1.	KUSHTETUTA (edhe anglisht)	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
11.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

1.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
2.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000
3.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600
4.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË	1500
5.	PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE	1500

DOLI NGA SHTYPI

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	1500
TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	2000

Doli nga shtypi më 20.1.2005

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2005

Çmimi 150 lekë